



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm, Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës, me datën 27 korrik 2019 bënë:

### **SHPALLJE PUBLIKE- RISHPALLJE**

**I.** Për angazhimin e dy (2) ekspertëve të jashtëm, për kryerjen e detyrave të caktuara në fushën e auditimit:

1. Një (1) ekspert për sigurinë në ushqim – për 10 ditë pune; dhe
2. Një (1) ekspert për sigurinë në komunikacionin rrugor – për 8 ditë pune.

**II. Kandidatët që shprehin interesim për angazhim duhet t'i plotësojnë kriteret e caktuara.**

1. Kandidatët për sigurinë në ushqim, duhet të jenë të diplomuar në teknologji ushqimore, Biologji apo Kimi. Preferohen njohuri dhe trajnime adekuata në fushën e sigurisë së ushqimit, specifikisht për standardin ISO/22000:2018 për sistemet e menaxhimit të sigurisë në ushqim dhe kërkesat për secilën organizatë që merret me zinxhirin ushqimor.
2. Kandidatët për sigurinë në komunikacionin rrugor, duhet të jenë të diplomuar në shkencat teknike në fushën e inxhinierisë së trafikut dhe transportit. Përparësi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet e larta, që posedojnë hulumtime, publikime dhe ekspertiza të lidhura me sigurinë rrugore.
3. Kandidatët duhet të kenë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në fushën përkatëse.

**III. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:**

1. Letër Motivuese; 2. Biografi (CV); 3. Kopjen e letërnjoftimit; 4. Dëshminë për studimet universitare;
5. Kopjet e trajnimeve relevante të kryera (nëse ka); 6. Dëshmitë mbi përvojën e punës në fushën përkatëse; dhe 7. Referencat apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatin që aplikon.

**IV. Përzgjedhja e kandidatëve**

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas procedurës së përcaktuar me Udhëzimin e Administrativ Nr. 02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm. Procesi i angazhimit të ekspertëve për punë ditore me qëllim të ekspertizës profesionale për çështje të caktuara, të cilat janë objekt i auditimit, gjenë mbështetje në Ligjin Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit. Për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë audituese, kjo është e drejtë diskrecionale për Auditorin e Përgjithshëm (neni 12.2 i Ligjit).

Me kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet sipas pikës II dhe III të kësaj shpalljeje mund të organizohen takime konsultative/intervisat me qëllim të qartësimit të angazhimit të tyre, lidhur me kushtet dhe për rezultatet e pritura nga angazhimi i tyre.

***Kandidatët të cilët kanë konflikt interesi, përkatësisht janë të angazhuar në fushat përkatëse në kuadër të institucioneve publike të cilat hyjnë në kuadër të fushëveprimit të auditimit, nuk mund të përzgjedhen në cilësinë e ekspertit sipas kësaj shpalljeje.***

Angazhimi në cilësinë e ekspertit nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit. Ekspertët e përzgjedhur do të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës për ditët e caktuara të punës. Marrëveshja lidhet sipas dispozitave të aplikueshme të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Angazhimi i ekspertëve bëhet në bazë ditore. Për punën e kryer bëhet kompensimi në vlerën e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2017 për Angazhimin e Ekspertëve të Jashtëm.

Angazhimi i ekspertit për sigurinë në komunikacionin rrugor pritet të bëhet menjëherë pas përfundimit të procedurave sipas kësaj shpalljeje, kurse e ekspertit për sigurinë në ushqim nga data 26 gusht 2019.

Eksperti i angazhuar duhet të respektojë standardet e zbatueshme të auditimit të njohura ndërkombëtarisht, Kodin e Etikës dhe rregullat tjera të përcaktuara me aktet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

#### **V. Detyrat:**

Termet e referencës së bashku me qëllimin e angazhimit si dhe përshkrimin e detyrave të punës mund të merren nga faqja e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, në <http://www.zka-rks.org/>

#### **VI. Dorëzimi i dokumenteve**

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, në adresën: **Prishtinë, rruga Ahmet Krasniqi nr. 210 ose përmes postës elektronike: [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org)**

Dokumentacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara, pa dëshmi).

Mundësia për aplikim mbetet e hapur **tetë (8) ditë** kalendarike nga dita e shpalljes, respektivisht deri me datën 4 gusht 2019, në ora 16:00.

**Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore të ZKA-së, në numrin e tel: 038 606004 lok. 1005, çdo ditë pune prej orës 08:00-16:00.**